



KMDK SH.A	Dalëse <input type="checkbox"/>
	Hyrëse <input type="checkbox"/>
Nr: <u>447/2018</u>	
Data: <u>25.07.2018</u>	
Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A Kosovo Landfill Management Company J.S.C Kompanija za Upravljanje Deponijama na Kosovu DD	

Në bazë të nenit 20, të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 130, të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikes dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 6, të Ligjit Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, në baze të nenit 5, të Rregullores (MPMS) Nr. 04/2016 për Kërkesat Minimale për Sigurimin e Shenjave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, si dhe në bazë të nenit 7, të Statutit të Kompanisë, Bordi i Drejtoreve të KMDK SH.A, miraton këtë:

RREGULLORE Nr. 12/2018, PËR SHENJAT E SIGURISË, SHENJAT E TJERA PËR PËRDORIM DHE TABELAT INFORMUESE NË KMDK SHA

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

- 1) Me këtë rregullore përcaktohen dhe përshkruhen kërkesat minimale për vendosjen dhe përdorimin e shenjave të sigurisë dhe sinjalistikës me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe ofrimin e sigurisë gjatë aktivitetit dhe punëve operative në KMDK SHA për të gjithë të punësuarit dhe shfrytëzuesit e objekteve dhe hapësirave të Kompanisë.
- 2) Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e vendosjes, numri i nevojshëm, lloji dhe formati i shenjave të sigurisë.
- 3) Përmes kësaj rregulloreje do të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi, si dhe specifikat për simbolet grafike, ngjyrat e sigurisë dhe shenjat e sigurisë të regjistruara dhe të përcaktuara në standardin (ISO 7010: 2013)

Fusha e zbatimit

Neni 2

- 1) Kjo rregullore zbatohet në çdonjërin nga deponitë sanitare, stacionin e transferit si dhe në objektet apo hapësirat me të cilat menaxhon KMDK SHA.
- 2) KMDK SH.A do të vendosë shenjat e sigurisë aty ku ushtrohet veprimtari, punë apo shërbim sipas përkufizimeve nga neni 3. i kësaj rregulloreje.
- 3) Shenjat e sigurisë, shenjat e tjera dhe tabelat informuese për përdorim në KMDK SH.A do të selektohen dhe do të përmbliidhen në grupe të klasifikuara konform kuptimit të tyre dhe qëllimit të përdorimit.
- 4) Shenjat e komunikacionit do të përdoren për të rregulluar qarkullimin e brendshëm të makinerive në deponitë sanitare sipas dispozitave në fuqi për trafikun rrugor si dhe në zbatim të Rregullores Nr. 06/2017, "Për menaxhimin e mbeturinave në deponite sanitare të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A."
- 5) Numri i shenjave të komunikacionit rrugor do të jetë minimal dhe ka të bëjë vetëm për nevojat e brendshme siç janë orientimi i lëvizjes së automjeteve dhe/ose makinerive si dhe masat kufizuese sa i përket shpejtësisë dhe peshës.

Përkufizimet

Neni 3

Termet e përdorur për qëllime të kësaj rregulloreje, kanë këto kuptime:

- a) "**Shenja/sinjalistika për sigurinë dhe/ose shëndetin**", është shenja/sinjali që ka të bëjë me ndonjë objekt të veçantë, aktiviteti ose situatë, dhe përmes së cilës jepen informacionet apo udhëzimet në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë përmes mbishkrimeve, shenjave, ngjyrave, sinjaleve ndriçuese, sinjaleve akustike (të zërit, beep-sinjali), sinjaleve të komunikimit apo përmes sinjaleve me gjeste të duarve.
- b) "**Shenja/sinjali i ndalimit**", është shenjë që ndalon veprimet (aktivitetet) të cilat mund të sjellin (nxisin) ose të shkaktojnë rrezik.
- c) "**Shenja paralajmëruese**", është një shenjë që paralajmëron rrezikun.
- d) "**Shenja për veprime obligative/të detyrueshme**", është shenjë që përshkruan një sjellje të përcaktuar.
- e) "**Shenja për dalje emergjence ose për ndihmën e parë**", është shenja e cila jep informatat mbi daljet emergjente në rast nevoje apo objektet e ndihmës së parë dhe të shpëtimit.
- f) "**Shenja informuese**", është shenja e cila jep informacione të ndryshme të përmendura nga pikat b) deri te pika e) e këtij neni.
- g) "**Tabela/Shenja me mbishkrim apo etiketë**", është shenjë e cila jep informacione specifike dhe ka kombinime të caktuara gjeometrike sa i përket formave, ngjyrave, simboleve ose piktogramës, dhe e cila është e dukshme, ndërsa kur mbi të bie drita ajo ndriçon me një ashpërsi të caktuar.
- h) "**Tabelë plotësuese/Shenjë me mbishkrim shtesë-Tabelë suplementare**", është shenja e cila përdoret në kombinim me një nga shenjat e përcaktuara në pikën g) të këtij neni dhe që jep informata shtesë.
- i) "**Ngjyrat e sigurisë**", është ngjyra përmes së cilës jepet kuptimi saktësisht i caktuar.
- j) "**Simboli i vizatuar grafikisht ose piktogrami**", është figurë/imazh apo pamje e vendosur mbi një tabelë ose në një sipërfaqe të ndriçuar dhe e cila paraqet një situatë ose përshkruan një sjellje të përcaktuar.
- k) "**Shenjë/sinjal ndriçues**", është shenjë e prodhuar nga një aparat/pajisje e përbërë nga material transparent ose gjysmë i tejdukshëm, i cili është i ndriçuar nga brenda ose nga pas në mënyrë të tillë që të sigurohet sinjal ndriçues, duke lënë përshtypjen e sipërfaqes së ndriçuar.
- l) "**Sinjal akustik/Sinjalet e zërit (beep)**", është sinjal zanor i koduar të cilin e lëshon mjeti/pajisja e dizajnuar për atë qëllim, pa përdorimin e zërit të njeriut apo të zërit artificial.
- m) "**Komunikimi gojor/ verbal**", është porosia/mesazhi gojor i paracaktuar me përdorimin e zërit njerëzor ose të zërit artificial (sintesave vokale)
- n) "**Sinjalet me duar/veprimi me gjeste duarsh**", është lëvizja apo pozicionim i krahut ose dorës (shputës së dorës) në formë konvencionale për të drejtuar personin, që efektivisht kryen një punë, për të mos krijuar apo shkakuar rrezik për punëtorët.

KAPITULLI II OBLIGIMET E PËRGJITHSHME TË KMDK SH.A

Rregullat e përgjithshme

Neni 4

- 1) KMDK SH.A. me këtë rregullore vendos shenjat e sigurisë dhe shëndetit në punë në vendet ku rreziqet nuk mund të shmangen ose të reduktohen, vendosja e këtyre shenjave do të jetë në përputhje me dispozitat e Rregullores së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të datës 11.11.2016 me Nr. 04/2016 "Për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë".

- 2) KMDK SHA, do të zbatoj rregullat themelore të sigurisë dhe do të aplikoj mënyrat e duhura në organizimin e punës gjatë ekzekutimit të proceseve të punës duke vendosur shenja apo sinjalistikë të sigurisë konform obligimeve ligjore në fuqi.
- 3) Gjatë fazës së instalimit apo të vendosjes së shenjave të sigurisë, KMDK SH.A do të ketë parasysh vlerësimin e rrezikshmërisë si dhe do të kujdeset që shenjat e sigurisë të vendosen në mënyrën e duhur në një vend të caktuar dhe për afat kohor të përhershëm.
- 4) Sa i përket “Vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës” të përcaktuar për implementim me dispozitat e Nenit 16 të Ligjit Nr. 04/L-161, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, KMDK SHA do ta vejë në zbatim këtë kërkesë ligjore përmes Rregullores së brendshme si akt veçante, ndërsa në kuadër të obligimeve nga kjo fushe përmes kësaj rregulloreje do të përcaktohen vetëm shenjat e sigurisë duke u bazuar nga parashikimet e rreziqeve potenciale dhe pas konsultimeve paraprake me stafin e operatives.
- 5) Për zbatimin e dispozitave të kësaj rregulloreje, Kryeshefi Ekzekutiv me Vendim formon komision të veçantë për përcaktimin e shenjave, numrin e tyre, dhe mënyrën e vendosjes sipas dizajnit dhe ndërtimit të tyre, në përputhje me ligjet në fuqi, si dhe duke respektuar kriteret e standardit ISO 7010:2013.

KAPITULLI III

PËRDORIMI I SHENJAVE TË SIGURISË NË KMDK SH.A DHE LLOJET E TYRE

Llojet e Tabelave dhe Shenjave

Neni 5

- 1) Me qëllim të përmbushjes kërkesave ligjore dhe rregullative sa i përket shenjave të sigurisë, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë, SH.A do të vendosë në zbatim plotësimin e kushteve të sigurisë në përputhje me nevojat fushë-veprimtarisë dhe aktivitetit të saj sipas përcaktimeve nga nenet 6, 7, 8, 9, 10, dhe 11. të kësaj rregulloreje.
- 2) Përmes zbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje për përdorimin e shenjave të sigurisë, KMDK SH.A bën implementimin e Rregullores së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të datës 11.11.2016 me Nr. 04/2016 “Për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë” si dhe shtojcave të saj që nga **Shtojca I e deri te Shtojca IX.**
- 3) Llojet dhe kategorizimi i shenjave të sigurisë më saktësisht janë të përkufizuar me Standardin ISO 7010, duke përfshirë rolin dhe qëllimin e përdorimit të tyre, pastaj zbrërthimi i kuptimit sa i përket formës dhe ngjyrës si dhe domethënies së tyre.
- 4) Shenjat e sigurisë po ashtu janë të përkufizuara edhe me anekset e rregullores së MPMS Nr. 04/2016 “Për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë”
- 5) Lloji i shenjave, dhe kuptimit i tyre sipas ngjyrës, formës, piktogramës (figurës gjeometrike) sqarohet në tabelën 1. të **ANEKSIT I**, si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Kategorizimi i shenjave të sigurisë

Neni 6

- 1) Shenjat e sigurisë kategorizohen sipas funksionit të tyre si në vijim:
 - “E”, është kategoria për shenjat që tregojnë një rrugë evakuimi, vendndodhjen e pajisjeve të sigurisë apo të një strukture sigurie, ose një veprim sigurie (shenja të kushteve të sigurta);
 - “F”, është kategoria e shenjave të pajisjeve të zjarrit;
 - “M”, është kategoria e shenjave të veprimt të detyrueshëm;
 - “P”, është kategoria e shenjave të ndalimit;

- "W", është kategoria e shenjave paralajmëruese.
- 2) Në pajtim me dispozitat e paragrafit 1, të këtij neni do të jepet tabela nr. 2 e cila përmbledh shenjat e regjistruara të sigurisë sipas kategorizimeve të cekura nga Standardi ISO 7010 (reference standardi ISO 3864-1).
- 3) Tabela nr. 2 do të jetë e bashkëlidhur si **ANEKSI II**, i kësaj rregulloreje, ndërsa radhitja do të jetë sipas kategorizimeve nga paragrafi 1, i këtij neni.
- 4) Forma dhe përmasat e dizajnit dhe të prodhimit për të gjitha kategoritë e shenjave të paraqitura në grupet e shenjave sipas anekseve të kësaj rregulloreje i referohet specifikimeve të përcaktuara në tabelat 3, 4, 5, 6, dhe 7 të Standardit ISO 7010:2013.

Pllakati i Informuese i Kompanisë

Neni 7

- 1) Pllakati informues i Kompanisë, është shenjë zyrtare dhe ka karakter informativ në shërbim të përdorimit publik të deponisë, dhe do të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:
 - Emrin dhe logon e Kompanisë dhe adresën qendrore të Kompanisë me numrat e telefonit dhe ueb_faqen,
 - Emrin e Deponisë dhe numrin rendor të saj,
 - Numrin e telefonit të Menaxherit të Deponisë,
 - Numrin e telefonit të Udhëheqësit të Njësisë së Kontrollës së Brendshme Inspektuese
 - Numrat e telefonit të Emergjencave, dhe
 - Orarin e operimeve.
- 2) Pllakati informues i Kompanisë, do të vendoset te portat hyrëse e çdonjëres nga katër deponitë si dhe në stacionin e transferit, forma e Pllakatit do të jetë katërkëndësh kënddrejtë me dimensione 80 [cm]/vertikale x 140 [cm]/horizontale, ndërsa përmbajtja sipas të dhënave nga paragrafi 1, i këtij neni.
- 3) Tabela Informuese do të dizajnohet sipas kriterëve të përcaktuara në paragrafin 1, dhe 2, të këtij neni, dhe do të bashkëlidhet me këtë rregullore në formë të **ANEKSIT III**.

Shenjat e komunikacionit rrugor brenda Deponive

Neni 8

- 1) KMDK SHA do të vendosë shenjat të caktuara të komunikacionit rrugor të domosdoshme për sigurinë e lëvizjes dhe të qarkullimit gjatë operimit brenda deponive sanitare.
- 2) Për orientimin e lëvizjes dhe kufizimet në përshtatje të ngarkesës dhe të terrenit gjatë drejtimit të kamionëve dhe manovrimin e makinerive të rënda si dhe në funksion të rregullave të sigurisë KMDK SHA vendos këto shenja të komunikacionit:
 - a) shenjat informuese të komunikacionit për lëvizje obligative.
 - b) shenjat e komunikacionit të cilat e kufizojnë shpejtësinë maksimale për të gjitha automjetet brenda deponisë në 10 [km/h].
 - c) shenjat e komunikacionit të cilat kufizojnë shpejtësinë maksimale në pjesët e pjerrëta në [5km/h], dhe
 - d) shenja të cila e kufizojnë peshën mbi urën matëse jo me shume se 40[t]
- 3) Numri i tabelave do të jete se paku nga një sosh për secilën kategori, ndërsa forma e tyre e rumbullaket dhe ngjyrat në përputhje me shenjat e komunikacionit rrugor.
- 4) Rregullat e tjera sa i përket aspektit të sigurisë aplikohen konform ligjit për drejtim e automjeteve në qarkullimin rrugor, përfshirë rripat e sigurisë, dritat, sinjalet, sistemet e frenimit e etj.
- 5) Rregullat e qarkullimit të makinerisë se rënd bëhen në përputhje me dispozitat e Rregullores Nr. 05/2017 " Për përdorimin, manovrimin dhe mirëmbajtjen e makinerive të rënda si dhe të makinerive tjera të disponueshme në deponitë sanitare të KMDK SH.A",

- si dhe në pajtim me udhëzuesit teknik, ndërsa shenjat e sigurisë për rreziqet nga makinat apo mekanizmat e tjerë të makinës vendosen në formë të etiketave në vende të dukshme dhe aty nga ku pritet burimi i rrezikut.
- 6) Tabelat e përshkruar në paragrafin 1, dhe 2, të këtij neni, do të jenë të bashkëlidhura si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje në formë të **ANEKSIT IV**.

Shenjat për përdorim të pajisjeve mbrojtëse personale (PMP)

Neni 9

- 1) KMDK SHA, në zbatim të Ligji të Punës Nr. 03/L-212 si dhe të Ligjit Nr. 04/L-161 "Për sigurinë dhe shëndet në punë", në përputhje Rregulloren e MPMS Nr. 02/2016 "për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës" si dhe në harmoni me rregulloren e veçantë të brendshme për Pajisjet Mbrojtëse Personale do të vendosë në hyrje të çdonjërës nga deponitë si dhe në stacionin e transferit nga një pllakat ne te cilin janë përfshirë te gjitha shenjat obligative për përdorim të pajisjeve mbrojtëse personale.
- 2) Shenjat për këtë kategori kane karakter mandator/të detyrueshme, dhe kanë karakteristikat si në vazhdim:
 - a) Forma e shenjës e rrumbullakët me ngjyra të kaltër/blu, ndërsa piktograma/simboli i bardhë në sfondin e kaltër. Ngjyra e kaltër/blu duhet të mbuloj të paktën 50% të sipërfaqes së tabelës.
 - b) Kuptimi: Duhet të kryhet veprimi i dhënë nga shenja.
 - c) Teksti plotësues mund të shtohet nëse është e nevojshme për të përcjellë një mesazh më të qartë.
- 3) Pllakati do të jetë prej materiali të kombinuar dhe me veti ndriçuese dhe i përforcuar në një vend të dukshëm në hyrje të deponive.
- 4) Dimensioni i pllakatit do te jene 1.2 [m]/horizontale x 1.8 [m]/vertikale, dhe në të përfshihen të gjitha shenjat standarde për përdorimin obligativ të PMP-ve.
- 5) Pllakati me shenjën e pajisjeve mbrojtëse personale do të jetë e vendosur për afat të përhershëm kohor.
- 6) Shenjat e përshkruar në paragrafin 1, dhe 2, të këtij neni, do të jenë të bashkëlidhura si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje në formë të **ANEKSIT V**.
- 7) KMDK SHA përmes rregullores së brendshme për Pajisjet Mbrojtëse Personale (PMP) si akt i veçantë, do të jep përshkrimet dhe përcaktimet detaje për llojin dhe numrin e pajisjeve si dhe mënyrën e përdorimit te tyre.

Shenjat e daljes emergjente ose të ndihmës së parë

Neni 10

- 1) KMDK SHA, në zbatim të Ligjit Nr. 04/L-161 "Për sigurinë dhe shëndet në punë", si dhe në përputhje me rregulloret e brendshme për shëndet dhe siguri ne vendin e punës si dhe ne harmoni me standardet do të vendosë në objektet e punës të gjitha shenjat e nevojshme për dalje emergjente ose të ndihmës së parë.
- 2) Shenjat/tabelat për këtë kategori kanë karakter udhëzues të konditave të sigurisë dhe tregojnë drejtimin e rrugëve të evakuimit dhe shpëtimit, si dhe kanë karakteristika si në vazhdim:
 - a) Forma e shenjës është drejtkëndësh ose katror me ngjyrë të gjelbër/jeshile ndërsa piktograma e bardhë në sfondin jeshil. Ngjyra jeshile duhet të mbuloj te paktën 50% të sipërfaqes se tabelës.
 - b) Kuptimi: ku të shkoni në mënyrë të sigurt në raste urgjente.
 - c) Shenjat gjithsesi duhet të përmbajnë një simbol, ndërsa teksti plotësues mund të shtohet nëse është e nevojshme për të dhënë qartësinë e veprimit.

- 3) Shenjat e përshkruar në paragrafin 1, dhe 2, të këtij neni, do të jenë të bashkëlidhura si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje në formë të **ANEKSIT VI**.

Shenjat e identifikimit dhe lokalizimit të pajisjeve kundër zjarrit

Neni 11

- 1) KMDK SHA, në zbatim të dispozitave të Ligji Nr. 04/L-012 “Për mbrojtje nga zjarri” si dhe të Ligjit Nr. 04/L-161 “Për sigurinë dhe shëndet në punë”, pastaj në përputhje me rregulloret e brendshme për shëndet dhe siguri në vendin e punës si dhe në harmoni me standardet, në objektet e punës do të vendosë të gjitha shenjat e nevojshme për identifikimin dhe lokalizimin e pajisjeve kundër zjarrit.
- 2) Shenjat/tabelat për këtë kategori kanë karakter udhëzues të konditave të sigurisë dhe tregojnë lokacionin ku mbahen pajisjet e tilla, dhe kanë karakteristika si në vazhdim:
 - a) Forma e shenjës është drejtkëndësh ose katror me ngjyrë të kuqe, ndërsa piktograma e bardhë në sfondin e kuq. Ngjyra e kuqe duhet të mbulojë të paktën 50% të sipërfaqes së tabelës.
 - b) Kuptimi: tregon lokacionin e vendosjes së pajisjes.
 - c) Shenjat gjithsesi duhet të përmbajnë një simbol të qarte identifikues të pajisjes, ndërsa teksti plotësues mund të shtohet nëse është e nevojshme për të dhënë qartësinë e veprimit.
- 3) Shenjat e përshkruar në paragrafin 1, dhe 2, të këtij neni, do të jenë të bashkëlidhura si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje në formë të **ANEKSIT VII**.
- 4) KMDK SHA, përmes rregullores së brendshme për mbrojtje nga zjarri si akt i veçantë do të bëjë përshkrimet dhe përcaktimet detaje sa i përket implementimit Ligji Nr. 04/L-012 “Për mbrojtje nga zjarri”.

Shenjat e ndalimit

Neni 12

- 1) KMDK SHA në zbatim të Ligjit Nr. 04/L-161 “Për sigurinë dhe shëndet në punë”, në përputhje me rregulloret e brendshme për shëndet dhe siguri në vendin e punës si dhe në harmoni me standardet, në objektet e punës dhe në hapësirat e zonave punuese operative do të vendosë të gjitha shenjat e nevojshme për veprimet e ndalueshme si dhe për kufizimet e lëvizjes.
- 2) Shenjat/tabelat për këtë kategori kanë karakter obligativ të konditave të sigurisë dhe tregojnë masat parandaluese për kufizime të ndalesave, si dhe kanë karakteristika si në vazhdim:
 - a) Forma e shenjës është e rrumbullakët, rrethi i kuq me shirit diagonal të kuq, ndërsa piktograma e zezë në sfondin e bardhë. Ngjyra e kuqe duhet të mbulojë të paktën 35% të sipërfaqes së shenjës/tabelës.
 - b) Kuptimi: tregon ndalesat, masat kufizuese të veprimit.
 - c) Shenjat gjithsesi duhet të përmbajnë një simbol, ndërsa teksti plotësues mund të shtohet nëse është e nevojshme për të dhënë qartësinë e veprimit.
- 3) Shenjat e përshkruar në paragrafin 1, dhe 2, të këtij neni, do të jenë të bashkëlidhura si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje në formë të **ANEKSIT VIII**.

Shenjat paralajmëruese për rreziqet

Neni 13

- 1) KMDK SHA, në zbatim të Ligjit Nr. 04/L-161 “Për sigurinë dhe shëndet në punë”, në përputhje me rregulloret e brendshme për shëndet dhe siguri në vendin e punës si dhe në harmoni me standardet, në objektet e punës dhe në hapësirat e zonave punuese operative

do të vendosë të gjitha shenjat e nevojshme për veprimet parandaluese dhe për kufizimet e lëvizjes.

- 2) Shenjat/tabelat për këtë kategori kanë karakter paralajmërues të konditave të sigurisë dhe tregojnë zonat apo objektet e identifikuara me potenciale të rrezikshme, fizike, kimike apo biologjike si dhe kanë karakteristika si në vazhdim:
 - a) Forma e shenjës është trekëndësh i verdhë me shirit të zi, ndërsa piktograma e zezë në sfondin e verdhë. Ngjyra e verdhë duhet të mbulojë të paktën 50% të sipërfaqes së shenjës/tabelës.
 - b) Kuptimi: Rreziku i mundshëm prapa shenjës brenda një zone të caktuar.
 - c) Shenjat gjithsesi duhet të përmbajnë një simbol, ndërsa teksti plotësues mund të shtohet nëse është e nevojshme për të dhënë qartësinë e veprimit.
- 3) Shenjat e përshkruar në paragrafin 1, dhe 2, të këtij neni, do të jenë të bashkëlidhura si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje në formë të **ANEKSIT IX**.

Etiketat

Neni 14

- 1) KMDK SHA në zbatim të Ligjit Nr. 04/L-161 "Për sigurinë dhe shëndet në punë", në përputhje rregulloret e brendshme për shëndet dhe siguri në vendin e punës si dhe në harmoni me udhëzuesit teknik për makineri, rezervuare, kontonjerë dhe për enët nën presion si dhe në sistemet pneumatike e hidraulike do të vendosë etiketat e nevojshme. Përmes këtyre etiketave parandalohen veprimet, jepen kufizimet si dhe udhëzimet e përshkruara të procedurës së veprimit në përdorim të pajisjes apo të mjetit të caktuar.
- 2) Etiketat për këtë kategori kanë karakter paralajmërues dhe udhëzues për konditat e sigurisë, dhe vendosen mbi objekte, pajisje apo sisteme të identifikuara me potenciale shpërthyes apo kontaminuese të rrezikshme, këto etiketa kanë karakteristikat si në vazhdim:
 - a) Forma gjeometrike e etiketës mund të jetë e kombinimeve të caktuar, po ashtu ngjyrat dhe simbolet si dhe piktograma e caktuar në përputhje me nenet 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13, të kësaj rregulloreje.
 - b) Kuptimi: Rreziku i mundshëm në objektin, pajisjen apo sistemin e caktuar.
 - c) Etiketat gjithsesi duhet të përmbajnë një simbol, ndërsa teksti plotësues mund të shtohet nëse është e nevojshme për të dhënë qartësinë e veprimit.
 - d) Etiketa duhet të ketë dizajn dhe veçori që, kur të bie drita mbi etikete ajo të ndriçoj me një ashpërsi të caktuar.
 - e) Montimi i etiketave duhet të bëhet në pozicione të dukshme, në vende të caktuara sipas nevojës, qoftë në formë të palakueshme ose vetëngjithëse, apo edhe të grafikuara dhe të ngjyrosura.
 - f) Përjashtim në vendosjen e këtyre etiketave bëjnë objektet/pajisjet që janë për përdorim të shkurtër si dhe për ato të cilave materia/lënda mbushëse u ndryshohet shpesh.
- 3) Shenjat e përshkruar në paragrafin 1, dhe 2, të këtij neni, sipas nevojës do të jenë të përzgjedhura nga anekset e kësaj rregulloreje përmes komisionit të veçantë për përcaktimin e shenjave sipas paragrafit 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje.

Etiketat e inventarizimit të aseteve dhe pajisjeve

Neni 15

- 1) KMDK SHA, me qëllim të ruajtjes, kujdesit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve, objekteve, makinave dhe inventarit do të vendosë etiketat e inventarizimit aty ku kjo është e mundur.

- 2) Etiketat e kësaj kategorie kanë karakter të caktuar pronësie dhe bartje përgjegjësie mbi mirëmbajtjen dhe kujdesin ndaj objekteve të caktuar nga personat e ngarkuar me to, këto etiketa kanë karakteristikat si në vazhdim:
 - a) Forma e etiketave do të jetë drejtkëndësh i bardhë kornizuar me shirit të zi dhe me hapësirë të lire për shënim të numrit serik si dhe të kodit të inventarizimit.
 - b) Montimi i etiketave vetëngjitëse të inventarizimit duhet të bëhet në pozicione të dukshme, në vende të caktuara sipas komisionit.
 - c) Etiketat duhet të jenë në dy kopje, një për ngjitje dhe tjetra e arkivuar për korrespondencë/analogji si dhe për duplikat në rast humbje apo asgjësimi.
- 3) Kryeshefi Ekzekutiv, me vendim do të themeloj Komisionin për inventarizim të cilin komision do ta udhëheqë zyrtari i logjistikes.
- 4) Pas përfundimit të punës, Komisioni do të dal me raport të detajuar mbi të gjitha pajisjet si dhe me listën e pronësisë së caktuar mbi asetet e Kompanisë.
- 5) Baza e të dhënave (databaza) duhet të jetë digjitale dhe fizike, ndërsa lista e përgjithshme e plotësuar me numër referent ndaj të punësuarit.
- 6) Zyrtari i logjistikes duhet të kujdeset për azhurnimin e listës inventarizuese si dhe me kohë të plotësoj ndryshimet e ndodhura pas njoftimit dhe aprovimit nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv nëse bëhet fjalë për ndryshime të vogla.

Sinjalet ndriçuese/Shenjat ndriçuese

Neni 16

- 1) Në rast të situatave eventuale emergjente apo të paraqitjes së ndonjë rreziku të madh në deponitë sanitare me të cilat menaxhon KMDK SHA, të punësuarit mund të aplikojnë sinjal ndriçues sipas përshkrimeve të paraqitura në **ANEKSIN X**, të kësaj Rregulloreje.
- 2) Aneksi X është në përputhje të plotë me SHTOJCEN VI, të rregullores së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nr. 04/2016 “Për kërkesat Minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë në punë”.

Sinjalet akustike/Sinjalet e zërit (beep sinjalet)

Neni 17

- 1) Në rast të situatave eventuale emergjente apo të paraqitjes së ndonjë rreziku të madh në deponitë sanitare me të cilat menaxhon KMDK SHA, të punësuarit mund të aplikojnë sinjal akustik sipas përshkrimeve të paraqitura në **ANEKSIN XI**, të kësaj Rregulloreje.
- 2) Aneksi XI është në përputhje të plotë me SHTOJCEN VII, të rregullores së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nr. 04/2016 “Për kërkesat Minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë në punë”.

Komunikimi gojor/ verbal

Neni 18

- 1) Në rast të nevojave të punësuarit mund të aplikojnë komunikim verbal sipas përshkrimeve të paraqitura në **ANEKSIN XII**, të kësaj Rregulloreje.
- 2) Aneksi XII është në përputhje të plotë me SHTOJCEN VIII, të rregullores së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nr. 04/2016 “Për kërkesat Minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë në punë”.

Sinjalet udhëzuese me duar

Neni 19

- 1) Në rast të nevojave për lëvizjen dhe manovrimin e makinerive të rënda si dhe operimet me to, të punësuarit mund të aplikojnë sinjalet udhëzuese me duar sipas përshkrimeve të paraqitura në **ANEKSIN XIII**, të kësaj Rregulloreje.

- 2) Aneksi XIII, është në përputhje të plote me SHTOJCEN IX, të rregullores së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nr. 04/2016 “Për kërkesat Minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë në punë”.

Te dhënat e tjera plotësuese nevojshme simbolike, grafike dhe tekstuale

Neni 20

- 1) Brenda Objektit në hyrje të deponisë përgatitet dhe vendoset një Hartë/plan njëfaqësh me përmbajtje dalluese dhe piketime apo etiketa mbi hartë ku shihen:
 - a) sipërfaqja e deponisë, sektorët, lagunat dhe objektet e vendosura
 - b) lokacionet e hidrantëve për shuarje të zjarreve (apo të burimeve të ujit)
 - c) rrugët e hyrjes, të qarkullimit dhe të daljeve, dhe
 - d) Karakteristika të tjera relevante.
- 2) Lista nga katalogu i mbeturinave të parrezikshme të lejuara për deponim në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi
- 3) Numrat për thirrje të shërbimit të **zjarrfikëseve 193**, të **policisë 192**, si dhe numrin **ndihmës së shpejtë 194**.

Materiali i shenjave, simboleve dhe etiketave

Neni 21

- 1) Shenjat e sigurisë, janë nga materialet të ndryshme si dhe në formate të ndryshme dimensionale, ndaj ato duhet të përzgjidhen në harmoni me lokacionit/vendit ku vendosen dhe mjaftueshmërisë vizuale në dhënien e mesazhit të tyre.
- 2) Shenjat e sigurisë mund të jenë prej materialeve si në vazhdim:
 - a) metalike,
 - b) plastike,
 - c) i/e përzier
 - d) afishe vetëngjitese apo shirita.
- 3) Bazuar në përshkrimet e pragrafit 1, dhe 2, të këtij neni, përzgjedhjen e shenjave veç e veç dhe numrin e tyre e bën komisioni i cekur në paragrafin 5, të nenit 4, të kësaj rregulloreje duke u bazuar në të dhënat dhe karakteristikat e shenjave sipas anekseve.
- 4) Komisioni për përzgjedhjen e shenjave dhe simboleve të sigurisë duhet të merr në konsideratë që furnizimi dhe montimi i tyre të ketë kosto sa më të ulët, por që njëkohësisht të kujdesen që shenjave të mos u deformohet kuptimi dhe qëllimi i tyre si dhe të bëhet përshtatja e formatit me vendin e montimit.

KAPITULLI IV DETYRIMET E VEÇANTA TË KMDK SHA

Informacion dhe udhëzime për punëtorët

Neni 22

- 1) KMDK SH.A, do t'u sigurojë me kohë informacionin punëtorëve të vet si dhe operatoreve që kryejnë punë për Kompaninë, udhëzimet e duhura me gojë ose me shkrim në lidhje me kuptimin e shenjave të sigurisë që përdoren në punë dhe të njoftoj në vazhdimësi për të gjitha masat e nevojshme që lidhen me përdorimin e tyre.
- 2) Udhëzimet e KMDK SH.A për nga mënyra do të jenë të tilla që të kuptohen lehtë nga punëtorët, gjithashtu do të jenë të përshkruar edhe udhëzimet për kuptimin e karaktereve, veçanërisht ato që përmbajnë fjalët, dhe si për të vazhduar në situatat e zakonshme dhe të veçanta.

- 3) Të punësuarit duhet që në vazhdimësi të ndjekin udhëzimet e KMDK SH.A, në lidhje me shenjat e vendosura të sigurisë dhe të informojë rregullisht personat e autorizuar të Kompanisë rreth ndërmarrjes së masave të nevojshme që lidhen me përdorimin e tyre.

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëtorëve

Neni 23

- 1) KMDK SH.A, do të informojë dhe do të konsultohet me punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre mbi çështjet e shëndetit dhe sigurisë, në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-161 "Për sigurinë dhe shëndet në punë".
- 2) Konsultimet do të ketë për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe anekseve të saj që nga Aneksi I e deri te aneksi XIII, si dhe për të gjitha dispozitat e tjera në fuqi që përfshijnë çështjet që janë objekt i kësaj rregulloreje.

KAPITULLI V DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE


Neni 24

- 1) Për kuptim më të detajuar të shenjave të sigurisë në zbatim të kësaj rregulloreje përdoren anekset nga Shtojca I deri te Shtojca IX, e Rregullores së MPMS nr. 04/2016 "Për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë në punë".
- 2) Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë edhe anekset që nga Aneksi I deri te Aneksi XIII i kësaj rregulloreje.

Neni 25

